



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 06.09.2023

Nr: 180

Ora: 14:30

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 94, DATË 05.09.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.09.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor "Partia Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Franci Nuri.

**PALË E INTERESUAR:** "Partia Demokratike", përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

**OBJEKT:** 1.Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëor të Zgjedhjeve nr. 745, datë 04.09.2023;  
2.Ndryshimin e vendimit duke vendosur, Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, si

subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 94 regj., datë 05.09.2023.

Në mbledhjen e datës 06.09.2023, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 94, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 94, datë 05.09.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 07.09.2023, ora 12:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Elvis</b>	<b>Çefa</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>Lako</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>